



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 30.06.2021, mori në shqyrtim praktikatat e përgatitura nga drejtoritë teknike të ERE-s, dhe u shpreh si më poshtë:

1. Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 179, datë 08.11.2017, “Mbi certifikimin e shoqërisë “Operatori i kombinuar i gazit natyror” Albgaz sh.a.”, i ndryshuar.
2. Për një ndryshim në vendimin e bordit të ERE nr. 187, datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë Albgaz sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror”, i ndryshuar dhe një ndryshim në vendimin e bordit të ERE nr. 188, datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë Albgaz sh.a., në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror”, i ndryshuar.
3. Mbi modifikimin e licencës nr. 436, seria TGN19, për aktivitetin e transmetimit të gazit natyror, dhënë Trans Adriatic Pipeline AG Albania, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 15, datë 31.01.2019, “Mbi licencimin në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror, të Trans Adriatic Pipeline AG Albania, e rregjistruar pranë QKB, si degë e shoqërisë së huaj aksionare (sh.a.), Trans Adriatic Pipeline AG”.
4. Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë OST sh.a. për zgjatjen e periudhës kohore, të parashikuar në pikën 3, të vendimit nr. 89, datë 31.03.2021, “Mbi propozimin e shoqërisë Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a., “Për rregullat e tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike nga data 1 Prill 2021”
5. Mbi rishikimin e programit të transparencës dhe rregjistrimit të kërkesave dhe përgjigjeve të ERE-s.
6. Mbi shqyrtimin e kërkesës së FTL sh.a., për shtyrjen e hyrjes në fuqi të vendimit të bordit të ERE nr. 202, datë 02.12.2020, për miratimin e “Rregullores për procedurat e shitjes së tepricave të energjisë elektrike në tregun e parregulluar për shoqërinë publike të furnizimit”.